

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE**  
**“SUNRISE HILL” sh.p.k**

Tiranë, më datë 23/05/2024

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare “SUNRISE HILL” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

**NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “Sunrise Hill” sh.p.k.

**NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme:  
Ne Fushën e ndërtimit, Zhvillimit të pasurive të paluajtshme etj..

**NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Twin Towers, Tower B, kati 5, pranë BLC, Tiranë.

**NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj

Shoqërie, në para në vlerën 100.000 Lek. Kapitali ndahet në dy (2) pjesë dhe pronësia e kuotave

nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Ilir Qafa, lindur në Berat, më 09/06/1978, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033276346, zotëron 50% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (50.000) lekë.



2. Lemi Muçaj, lindur në Kodër Thumane, më 22/09/1969, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033817142, zotëron 50% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (50.000) lekë."

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

### **NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

### **NENI 7 - ORGANET DREJTUESE**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është Ilir Qafa, shtetas Shqiptar, i Lindur në Berat, më 09.06.1978, me nr. personal H80609066H, person madhor me zotësi të plotë juridike për të

vepruar, me një afat emërimi prej 2 (dy) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë

pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

### **NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe

për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

#### **NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**


Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**


Akt i Themelimit hartohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKËT**

Ilir Qafa

  
\_\_\_\_\_  
(emer, mbiemer, firme)

Lemi Muçaj

  
\_\_\_\_\_  
(emer, mbiemer, firme)